

VENDIM
Nr. 90, datë 13.5.2024

**MBI NJOHJEN E LICENCËS PËR TREGTIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE,
LËSHUAR NGA ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI E REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, PËR SUBJEKTIN “MFT ENERGY KOSOVO L.L.C”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 97, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 4, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.5.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 610/7 prot., datë 7.5.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi njohjen e licencës për tregtimin e energjisë elektrike, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës, për subjektin ‘MFT Energy Kosovo L.L.C’”,

konstatoi se:

- Subjekti “MFT Energy Kosovo”, degë e shoqërisë së huaj, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 610/4 prot., datë 23.4.2024, ka paraqitur kërkesën për njohje të licencës për tregtimin e energjisë elektrike, me numër ZRRE/Li_86/22, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji në Republikën e Kosovës, me vendimin V_1616_2022, datë 16.11.2022, për subjektin “MFT Energy Kosovo L.L.C”. Ky subjekt ka regjistruar në Republikën e Shqipërisë subjektin “MFT Energy Kosovo”, degë e shoqërisë së huaj.

- Me e-mailin e protokolluar me nr. 610/5 prot., datë 2.5.2024, ERE paraqiti pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës (ZRRE) kërkesën për informacion, në lidhje me vlefshmërinë e kësaj licence dhe në rast se kjo zyrë ka ndërmarrë ndonjë veprim për heqjen apo pezullimin e kësaj licence.

- Në përgjigje, me *email*-in e protokolluar në ERE me nr. 610/6 prot., datë 2.5.2024, ZRRE ka njoftuar se nuk ka filluar dhe as ka ndërmarrë ndonjë vendim për heqjen apo pezullimin e kësaj licence.

- Subjekti ka depozituar në ERE të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga neni 4, pika 3 dhe shtojca 1/K, e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores.

- Afati i njohjes së licencës do të jetë i njëjtë me afatin e licencës së lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës, pra deri më datë 15.11.2027.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë njohjen e licencës për tregtimin e energjisë elektrike, me nr. ZRRE/Li_86/22, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji në Republikën e Kosovës, me vendimin V_1616_2022, datë 16.11.2022, për subjektin “MFT Energy Kosovo L.L.C”, që ka regjistruar në Republikën e Shqipërisë subjektin “MFT Energy Kosovo”, degë e shoqërisë së huaj.

2. Njohja e licencës, sipas përcaktimeve të pikës 1, do të jetë e vlefshme deri më datë 15.11.2027.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë dhe Zyrën e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti